

Patenta për software?

Ligji dhe praktika Europiane



Përmbajtja

- 3** Shpikjet për implementime kompjuterike.
- 4** Patentat për shpikjet në implementime kompjuterike:
Si përfiton shoqëria?
- 8** Patentat Europiane: cilësi dhe siguri ligjore e lartë.
- 12** Praktika e ekzaminimit të EPO
- 17** Përmbledhje

Shpikjet e implementimeve kompjuterike

Njerëzit flasin shumë shpesh për patentat e softwareve— cfarë janë ekzaktesisht ato?

Termi “software” konsiderohet si i dyshimtë për arsye se mund ti referohet një listimi të programeve të shkruara në gjuhën programuese për implementimin e një algoritmi, por gjithashtu mund ti referohet një kodi binar të gjendur në një aparat kompjuterik dhe gjithashtu mund të shpjegojë dhe dokumentacionin shoqëruës. Për këtë arsye, në vend të përdorimit të këtij termi të dyshimtë është krijuar termi i shpikjeve për implementimet kompjuterike.

Shpikja për implementimet kompjuterike përfshin përdorimin e një kompjuteri, rrjeti kompjuterik apo aparate të tjera programuese, ku një apo më shumë karakteristika krijohen tërësisht apo pjesërisht me anë të një programi kompjuterik.

Zyra Europiane e Patetave (EPO) bazohet në ligjin European të patentave ashtu si përcaktohet në Konventën Europiane të Patentave (EPC) adoptuar nga 38 shtetet anëtare të European Patent.

Në EPC, një program kompjuterik i pretenduar si “i tillë” nuk është shpikje e patentueshme (Neni 52(2)(c) and (3) EPC). Patentat nuk grantohen specifikisht për një listim programesh. Këto listime mbrohen nga të drejtat e autorit. Që një shpikje për implementim kompjuterik të grantohet duhet të plotësojë kushtin e zgjidhjes së një problemi teknik në një mënyrë të re dhe inovative.

Patentat për shpikjet në implementime kompjuterike: Si përfiton shoqëria?

Patentat si një nxitje për inovacionin

Ndërkohë që teknologjia përparon, shpikjet e implementimeve kompjuterike po përdoren gjithmonë e më shumë në të gjitha fushat e teknologjisë. Në shumë raste, pjesa inovative e një produkti apo procesi mund të konsistojë në metodën kompjuterike programuese apo implementimin e saj. Duhet konsideruar një faktor tjetër që zhvilluesi, duke u varur nga rethanat (si psh. konsumimi i energjisë, shpejtësia e procesimit), ka mundësinë e zgjedhjes së implementimit të metodës si programim kompjuterik ose hardware (psh. me FPGA –“field-programmable gate arrays”).

Burimet e Kërkimit dhe Zhvillimit të cilat vihen në dispozicion të krijimit dhe tregëtimit të këtyre produkteve janë shumë të mëdha. Mbetet për tu përgjigjur nëse është e arsyeshme që mundimi i shpikësve të mos shoqërohet me përfitime financiare nga rezultatet e punës së tyre. Mbrojtja me patentë për shpikjet e implementimeve kompjuterike është po aq e merituar sa shpikjet në teknologjitë tradicionale.

Patentat grantohen në këmbim të bërjes publike të shpikjes

EPO granton patenta për shpikje të cilat i përmbahen kriterit strict të patentimit ashtu si përcaktohet në EPC. Në rast se shpikja në bazë të së cilës është bërë aplikimi i plotëson kriteret, aplikantit i grantohet patenta e cila është një e drejtë e përkohshme ekskluzive e cila u ndalon palëve të treta (përfshirë konkurrentet) përdorimin e shpikjes pa pëlqimin e pronarit të patentës. Në këmbim të patentimit, shpikja duhet të bëhet e njohur për publikun.



Kërkuesit shpesh shpikin bazuar në njohurinë sipas të cilës marrin mbrojtje ligjore për idetë e tyre. Eshte e vështirë të imagjinosh një biznes i cili hedh produktin në treg pa mbrojtur fillimisht patentën, vecanërisht në fusha të cilat kanë kosto të larta të zhvillimit të produktit dhe investimit. Për këtë arsye, patentat është një element jetësor për tregëtimin e suksesshëm. Inovacioni nuk do të ekzistonte nëse nuk do të aplikohesh mbrojtja e patentave.

Publikimi i aplikimeve për patentë i cili është i detyrueshëm të bëhet 18 muaj pas datës së depozitimit, i jep akses publikut në zhvillimet më të reja teknologjike. Duke publikuar këtë rrjedhje të ideve të reja, sistemi i patentimit shërben si një rrip transmetimi efektiv në shpërndarjen e dijes dhe informacionit në teknologji duke furnizuar në këtë mënyrë njohurinë bazë të shoqërisë.

Arkivi i patentave të EPO I quajtur Espacenet, aksesin në të cilin ofrohet falas, është më i madhi në botë duke përmbajtur mbi 80 milion dokumente që në vitin 2013. I pajisur me një mjet përkthimi për patentat, Përkthim Patente, Espacenet është një nga mjetet më të rëndësishme në shpërndarjen e njohurive ekonomike dhe një nga shtyllat bazë të inovacionit në Europë.

Patentat dhe bizneset e vogla

Të gjithë mund të aplikojnë për një patentë sipas EPC, e cila nuk përcakton ndryshim midis individeve, SMEve dhe korporatave të mëdha.

EPO, me mjetet dhe shërbimet që ofron synon të mbajë aksesin në mbrotjen e patentës të barabartë dhe njësoj tërheqëse si për individët, kompanitë dhe po ashtu institutet e kërkimit.

Ekzitojnë shumë pak prova të cilat sugjerojnë që SME-të nuk përfitojnë nga patentat: në të vërtetë, për sipërmarrjet inovative të cilat nuk kanë burime financiare të mjaftueshme dhe kanë një segment të gjerë tregu, patentat shpesh janë e vetmja mundësi për ti rezistuar konkurrencës.

Patentat Europiane: cilësi dhe vlefshmëri ligjore të lartë

Përpara se të bëhet grantimi i një patente europiane, çdo aplikim bëhet subjekt i një procedure të kërimit dhe ekzaminimi të hollësishëm nga një skuadër profesionale nga EPO cila përbëhet prej 3 personash. Nëpërmjet kësaj procedure sigurohet nëse aplikimi përmbush në mënyre strikte kërkesat e patentueshmërisë sipas EPC.

Kërkimi– situata specifike

Në rast se aplikimi i patentës konsiderohet që përmban vetëm material i cili përjashtohet nga patentimi, atëherë nuk mund të bëhet një kërkim domethënës. Në këtë rast publikohet një deklaratë e cila citon se nuk do të prodhohet një raport kërkimor. Rrjedhimisht, pjesa më e madhe e aplikimeve të tilla refuzohen nga EPO ose tërhiqen nga aplikanti.

Së bashku me raportin e kërimit (ose me deklaratën kur e zëvendëson), EPO prodhon dhe opinionin european të kërimit, në të cilin ekzaminuesi parashtron kundërshtimet e tij për aplikimin. Kjo i jep mundësi EPO që të përcaktojë në procedure në një stad shumë të herët se disa apo shumë nga kërkesat e aplikimit nuk janë të patentueshme duke u shoqëruar me arsyetimet përkatëse. Për shembull, një shpikje përjashtohet nga patentueshmëria për shkak të mungesës së karakterit teknik, ose sepse nuk ka hap shpikës.

Në këtë mënyrë, edhe aplikanti edhe publiku informohen shumë herët për shanset e një shpikje për tu patentuar.

A jepen patenta për shpikjet e “vogla”?

Shprehja “patente e vogël” përdoret shpesh për patenta për të cilat palët e treta mendojnë se nuk duheshin grantuar pasi nuk sjellin risi apo hap shpikës. Kjo do të thotë që shpikja e propozuar konsiderohet si e njohur për publikun ose shume e qartë për një person me njohuri teknike dhe si e tillë, bazuar në ligjin ekzistues, nuk kualifikohet si patentë.

Një arsye për këtë mund të jetë se shpikja paraqitet me përfitime minimale pas grantimit, por nuk është vlerësuar si e tillë me datën e prioritetit të aplikimit. Mekanizmat ligjorë për tu dhënë mundësi palëve të treta për të sfiduar këto patenta janë ekzistente. Mundësitë e ndërhyrjes së këtyre palëve për të ndërhyrë gjatë ekzaminimit janë të rëndësishme sepse bëjnë të mundur që patentat Europiane kanë një cilësi dhe siguri ligjore të lartë duke gëzuar vlefshmërinë në proceset gjyqësore. Kur ka përfunduar procesi i ekzaminimit në EPO dhe patentat lënë juridiksionin e EPO, diskutimet e mëvonshme në lidhje me vlefshmërinë dhe dhunimin e të drejtave të patentës Europiane janë subjekt i ligjeve kombëtare dhe vendimi përfundimtar jepet nga gjykatat e vendeve anëtare tek të cilat është grantuar patenta.

Të drejtat e largëta për palët e treta

EPC ofron mjete të ndryshme ligjore duke ju mundësuar palëve të treta të monitorojnë procedure dhe gjithashtu të sfidojnë vendimet e EPO, psh. kur një shpikje e re del ne dritë.

Procedurat e EPO parashikojnë:

- inspektim online falas nga publiku pas publikimit të aplikimit
- observime nga palët e treta në aplikime akoma të papërfunduara dhe në procedure kundërshtimi apo apelimi
- kundërshtime nga palët e treta për patentat e grantuara
- apeline nga palët e treta të cilat preken jo në mënyrë të drejtpërdrejtë nga vendimet e EPO në procedurat e grantimit apo kundërshtimit;
- kufizime për mbrojtjen e patentës pas grantimit

Inspektimi për patentat e publikuara apo deponimi i vërejtjeve nga palët e treta bëhet pa pagesë.

(I disponueshëm në www.epo.org/register).

Palët të cilat bëjnë kundërshtime të procedurave të EPO nuk janë të detyruara të kenë interes ekonomik apo ligjor në patentën; gjithkush mund të deponojë një kundërshtim të patentës së grantuar.

Pas procedurave të EPO (në gjyqin e kombëtar)

- veprime për revokimin e patentës Europiane.

ERP



Praktika e ekzaminimit në EPO

Ligji

Pika fillestare e dhënies së patentës për shpikjet e implementimeve kompjuterike është kushti që parashikon se patenta grantohet për cdo shpikje, në cdo fushë të teknologjisë me kusht që të sjelli risi, përbëjë një hap shpikës, të jetë e zbatueshme në industri dhe nuk përjashtohet specifikisht nga mbrojtja (Article 52 EPC).

Mbrojtja e Patentave për krijimet teknike

EPC parashikon kushtet për patentim si sjellja e risisë, hapin shpikës dhe aplikimin në industri me detaje (Articles 54, 56 dhe 57 EPC) por nuk parashikon një përkufizim ligjor për termin “shpikje”. Gjithsesi, mbrojtja e krijimeve teknike me patente ka qënë tradite Europiane që në fillimin e sistemit të patentimit. Prandaj, subjekti për të cilën kërkohet mbrojtja me patentë duhet të ketë karakter teknik ose, për të qënë më të saktë të përfshijë “mësimin teknik” si p.sh. udhëzimin e adresuar tek një person me njohuri teknike se si të zgjidhë një problem të caktuar teknik duke përdorur mjete specifike teknike. Pra, zgjidhja e problemit nga shpikja duhet të jetë teknike jo vetëm financiare, tregëtare apo matematike. Ky kusht duhet të përmbushet plotësisht në mënyrë që një patentë të mos përjashtohet nga patentueshmëria.

Edhe pse ligji nuk e përcakton termin “shpikje”, ai përcakton një listë me tema subjekti të cilat nuk konsiderohen si “shpikje”. Mes shembujve konkretë të përmendur në këtë listë janë dhe “programet për kompjuterat”. Duhet të theksohet se tema ose subjekti ose aktivitetet në listë janë përjashtuar vetëm nëse aplikimi i patentës Europiane apo patenta i referohet atyre si të “tilla”. Për këtë arsye, shpikjet të cilat kanë një karakter teknik të cilat implementohen ose mund të implementohen nga programe kompjuterike nuk përjashtohen nga patentimi.

Çeshtjet e bordit të apelit

Shumë vendime të bordit të apelit në fushën e shpikjeve për implementimet kompjuterike, kanë zhvilluar interpretimet e provizioneve të EPO që lidhen me termin “shpikje” duke sjellë udhëzim në çfarë është e patentueshme ose jo

Bordi I Apelit, I cili gëzon pavarësi në funksionin e vendimmarrjes, ka detyrën e rivlerësimit të vendimeve të EPO në procesin e grantimit dhe kundërshtimit të patentës. Bordi interpreton EPC në rast se ngrihen diskutime duke konsideruar çfarë është përfshirë dhe jo si dhe arsyetimet përkatëse. Roli I tij është instrumental në zhvillimin e praktikës së patentës në EPO.

Çeshtjet ligjore në EPO tregojnë se kontrolli apo ndërmarrja e një procesi teknik nuk përjashtohet nga patentimi, pavarësisht nëse implementohet nga një “hardware” apo “software”. Pra, nuk ka rëndësi nëse procesi ndërmerret nga qarqe specifike apo nga një program kompjuterik, por nga faktorët ekonomikë dhe teknologjikë; patentimi nuk duhet kundërshtuar me bazat e përfshirjes së një programi kompjuterik.

Një kërkesë specifike për mbrojtjen e një shpikje për implementime kompjuterike është “programi kompjuterik /produkt i programit kompjuterik”. Kjo kërkesë u krijua për të mundësuar mbrojtjen më të mirë ligjore për shpërndarjen e programeve kompjuterike në transportues të të dhënave dhe jo duke formuar një pjesë të një sistemi të kompjuterizuar. Kërkesa nuk duhet ngatërruar me termin “program kompjuterik”.

Subjekti I kërkesës nuk përjashtohet nga patentimi nëse program kompjuterik i cili vjen si rezultat i metodës në fjalë është i aftë që, me vënien në punë në një kompjuter, të sjelli një “efekt teknik” duke shkuar më tej ndërveprimin fizik midis programit kompjuterik dhe hardware të kompjuterit.

Efektet fizike normale të programit të ekzekutimit si psh. rrymat elektrike, nuk janë të mjaftueshme për tu cilësuar si “ me karakter teknik” dhe për këtë arsye kërkohet një efekt real teknik si psh: kontrolli i nje procesi industrial apo funksionimi i nje pjese të makinerisë dhe gjithashtu funksionimi i bredshëm i vetë kompjuterit (organizimi i memories, ekzekutimi i programeve) nën influencën e një programi kompjuterik.

Për shembull, një metodë e kodimit të informacionit të audios në një sistem komunikimi mund të ketë si qëllim të reduktojë shtrembërimin nga zhurmat e kanalit. Edhe pse, ideja e cila nënvizon këtë metodë mund të konsiderohet e mbështetur në metodën matematikore, metoda e kodimit si e plotë nuk është një metodë në vetvete, dhe si e tillë nuk përjashtohet nga patentimi Neni 52(2)(a) dhe (3) EPC. Në mënyrë të ngjashme, një metodë e enkriptimit / dekriptimit apo firmosjes së komunikimeve elektronike mund të konsiderohet si metodë teknike, edhe pse në thelb bazohet në një metodë matematikore.

Nga ana tjetër, “skemat, rregullat dhe metodat për (...) për të bërë biznes “ nuk janë të patentueshme; por një metodë e re e cila zgjidh një problem teknik, jo thjesht administrativ, mund të jetë e patentueshme.

Disa vendime të çështjeve gjyqësore

Dy identitete/Comvik (T 641/00)

Teknike por jo risi

Një kartë SIM ka dy identitete (p.sh profesionale dhe private)

Një shpikje e cila konsiston në një ndërthurje të tipareve teknike dhe tipare jo teknike dhe si e tërë duke pasur një karakter teknik duhet konsideruar për kërkesat e hapit shpikës duke marrë parasysh të gjitha tiparet që përbëjnë karakterin teknik, ndërsa tiparet të cilat nuk japin kontribut nuk mund të ndihmojnë në dëshminë e hapit shpikës.

Metoda e tenderimit/Hitachi (T 258/03)

Teknike por jo risi

Një mënyrë tenderimi e cila aplikohet nëpërmjet internetit e karakterizuar nga rregullat e tenderit.

Në këtë rast u konsiderua se zgjidhja e problemit e sugjeruar nga aplikanti nuk e zgjidhte problemin por krijonte zgjatje në procedurën e zgjidhjes. (Për më tepër u zbulua se cdo metodë e cila përfshin një mënyrë teknike duhet konsideruar një shpikje)

Simulimi i qarkut / Teknologjitë Infineon (T 1227/05)

Teknike dhe hap shpikës

Aplikimet e veçanta teknike të metodave simuluese kompjuterike që zbatohen edhe nëse përfshin formula matematikore, konsiderohen si “shpikje” sic është shprehur në Nenin 52(1) EPC. Simulimet e qarkut zotërojnë karakterin e nevojshëm teknik, sepse ato formojnë një pjesë thelbësore të procesit të fabrikimit të qarkut.

Një kuadër i besueshëm

Presidenti i EPO i ka drejtuar një numër pyetjesh Bordit të Zgjeruar të Apelit për të marrë një shpjegim të detajuar në lidhje me patuentshmërin e programeve kompjuterike. Sipas mendimit të tij G 3/08 Bordi i Zgjeruar u shpreh se çdo divergjencë e mundur në ligj me kalimin e kohës ishte një zhvillim normal në një botë në ndryshim dhe se është praktik e EPO që jo vetëm e imagjinushmja dhe e besueshmja të ndikojnë në rezultatet e saj. Ajo në thelb pohoi status-quoton, domethënë qasja pragmatike e zgjidhjes së problemeve siç është përcaktuar në T 641/00 (Comvik) dhe T 258/03 (Hitachi).

Që atëherë ligji i EPO ka arritur një situatë të qëndrueshme, duke siguruar parashikueshmëri për aplikantët për shpikjet e zbatuar kompjuter.



Përmbledhje

EPC si është interpretuar edhe në ligj mundëson dhe detyron EPO të japë patenta për shpikje në shumë fusha të teknologjisë mes të cilave programet kompjuterike të cilat kanë rëndësi dhe japin kontribut teknik. Fusha të tilla përfshijnë pajisjet mjekësore, sektorin auto- emotiv, hapësirën ajrore, kontrollin industrial, komunikimi me teknologji të tilla si të automatizuara për njohjen e zërit, përkthim gjuhës natyrore, dhe komunikimit me video, dhe gjithashtu kompjuter / procesorin në vetvete.

Sipas ligjit të EPO pyetjes a “kemi të bëjmë me një shpikje?” domosdoshmërisht i paraprijnë të gjitha vlersimiet e tjera të patentimit përshëmbull (risi, hap shpikës dhe zbatueshmëria në industri dhe në mënyrë të heshtur nënkupton pyetje të mëtejshme: “A kanë këto shpikje karakter teknik?” Të ashtëquajtura jo-shpikje (ato të përjashtuara shprehimisht nga neni 52 EPC, të tilla si metodat e të bërit biznes, metodat matematikore apo prezantimet e informacionit) bejnë pjesë në mbretërinë e patentimit me përdorimin e mjeteve teknike në Evropë , të tilla si një kompjuteri ose rrjetet kompjuterike.

Programet kompjuterike për zbatimin e një metode të biznesit, megjithatë, nuk do të jetë krijuese pasi ato vijnë nga kufizimet jo-teknike të kërkesave të veçanta të biznesit, zbatimi i të cilave në një kompjuter tradicional është i qartë.

Cilësia e lartë e praktikës së egzaminimit të EPO sëbashku me të drejtën e palëve të treta për të komentuar dhe kundërshtuar vendimin e kësaj zyre bën të mundur që vetëm ata aplikant që përmbushin detyrimet e EPC të patentohen.

Publikuar nga

Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave
Shqipëri
©DPPM 2016

Responsible for the content

Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave

Dizajn

AAG Publicity

Përkthyer nga:

AAG Publicity

Përkthim i edituar nga:

Drejtoria e Koordinimit, Promovimit të PI dhe
Trajnimeve
Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave

Printim

AAG Publicity

Botimet mund të shkarkohen pa pagesë nga faqja e internetit e EPO-s në adresën:
www.epo.org/teaching-kit.

“E Drejta e Autorit dhe Lirimi nga Përgjegjësia: Ky material është krijuar, përkthyer apo adaptuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave (**DPPM**) me mbështetjen e Zyrës Europiane të Patentave (**EPO**).

EPO nuk garanton që materiali nuk përmban gabime apo mungesa në të dhe zhvishet nga çdo përgjegjësi që lidhet me besueshmërinë e saj apo me pazotësinë e saj në përdorime dhe dëmtime të tjera të mundshme të kësaj natyre, humbje të informacionit, fitime apo të ardhura.

Versioni origjinal mund të jetë i disponueshëm në:
www.epo.org”

Ku mund të kërkojmë informacion shtesë





Vizito faqen www.epo.org

- > Kërkimi për patentat www.epo.org/espacenet
- > Regjistri European I Patentave www.epo.org/register
- > Shërbimet e depozitimeve online www.epo.org/online-services
- > Vende të lira pune www.epo.org/jobs
- > Akses I shpejtë në FAQs, publikime, formularë dhe te tjera. www.epo.org/service-support

Vizito www.epo.org/contact për akses

- > formulare kontakti për të derguar kërkesat me postë
- > orientim për tu drejtuar në EPO
- > adresa postare e EPO
- > numrat e kontaktit të EPO
- > numrat e kontaktit të EPO për Shërbimin ndaj Klientit

Ndiqni EPO në

- > [www.facebook.com /europeanpatentoffice](https://www.facebook.com/europeanpatentoffice) 
- > [Twitter.com / EPOorg](https://twitter.com/EPOorg) 
- > www.youtube.com/EPOfilms 
- > www.linkedin.com/company/european-patent-office 



www.epo.org
info@epo.org



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PATENTAVE DHE MARKAVE

Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark",
Prona nr.33, Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë
Tel: +335(0)42236288,
Email: info@dppm.gov.al